



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 06
Data 14. 04. 2008

P R O C E S V E R B A L

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Të pranishëm në mbledhje ishin:
Shkumbin Demalija, Bojan Stojanović Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Eqrem Kryeziu,
Agim Veliu, Gani Geci, Zafir Berisha dhe Zylfi Merxha

Mungoi: Bujar Bukoshi.

Nga zyra mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Biljana Petrović, Antigona Ibraj.

Mbledhja filloi në orën 11:00 në sallën N-225, në ndërtesën e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja filloj me këtë rend dite:

R e n d i i d i t ë s:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 07.03.2008
3. Shqyrtimi i propozim amendamenteve për Projektligjin për Përdorimin Civil të Eksplozivëve
4. Të ndryshme

Pika e parë: Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

Pika e dytë: Procesverbali i mbledhjes së datës 07.03.2008, u miratua pa vërejtje.

Pika e trete: Në fillim të kësaj pike kryesuesi ja dha fjalën anëtarit të komisionit z. Naim Maloku i cili ishte Raportues për këtë projektligj. Ai fillimisht njoftoi komisionin për rrjedhën e aktiviteteve që kishte zhvilluar grupi referues gjatë procesit të shqyrtimit dhe amendamentit të tij, duke nxjerr 21 amendamente.

Pas shqyrtimit të amendamenteve një nga një nga ana e komisionit, gjithsej u aprovuan 18 amendamente të propozuara nga grupi referues dhe u miratuan edhe dy amendamente tjera të propozuara nga komisioni. Pra gjithsej u miratuan 20 amendamente për këtë projektligj, të cilat do të procedohen në shqyrtim të mëtejshëm siç parashihet në Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Pika e katërt: Në lidhje me këtë pikë z.Zylfi Merxha tha: siç e dimë, çdo ditë në gazeta shkruan se 1600 policë janë nën hetime. Ne si komision parlamentar për siguri a duhet të jemi të obliguar ta dimë se çka po ndodh a jo.

Kryetari i komisionit në lidhje me këtë pikë tha: ju jeni të njoftuar se me 21 prill do ta mbajmë dëgjimin me segmentet e sigurisë në Kosovë. Por unë propozoj që një orë para dëgjimit ne të takohemi në mënyrë që të diskutojmë se si do të paraqitemi para tyre, dhe normal që në këtë dëgjim do ta kemi parasysh edhe çështjen që e paraqiti z.Zylfi Merxha. Një çështje tjetër të cilën unë dua ta përfshij në këtë pikë ka të bëjë me rekomandimin e Agjencionin kundër korrupsionit, të cilin e ka sjell komisioni për buxhet dhe financa, prandaj kërkoj që ti përkrahim këto rekomandime. Anëtarët e komisionit i përkrahen këto rekomandime.

z.Rrustem Mustafa tha se, pika tjetër që do ta përfshij këtu ka të bëjë me vizitën që e kanë organizuar OJQ FIQ dhe Saferworld, dhe bashkërisht me ju kisha dashur ta caktojmë një ditë se kur do ta bëjmë këtë vizitë dhe kush do të shkoj. Gjithashtu kisha kërkuar nga ju që të jemi sa më serioz në këto çështje, e jo të shkojmë siç kemi shkuar në Qendrën për trajnim policor në Vushtrri vetëm dy vetë .Prandaj kërkoj që të jemi ma korrekt në punët që i caktojmë ne. Unë gjithashtu kisha dashur të kërkoj nga Gr. Parlamentar i LDK-së ta zëvendësoj anëtarin i cili nuk po vjen. Kjo duhet të bëhet për arsye se punët në komision çdo ditë e ma shumë po shtohen.

Pasi që nuk ka dikush diçka tjetër për të shtuar me kaq e mbylli këtë takim për sot.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

Kryetari i Komisionit
Rrustem Mustafa